

Përceptimet e laborantëve mjekësorë në lidhje me sigurinë e pacientit dhe raportimin e gabimeve klinike në Kosovë

Diellza Bajramaj<sup>1</sup>, Dua Danjoli<sup>2</sup>

**Abstrakti**

*Hyrje:* Rezultatet laboratorike luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në diagnostifikime dhe trajtime mjekësore; si rrjedhojë e kësaj, gabimet laboratorike kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në sigurinë e pacientit. Qëllimi i këtij punimi është të vlerësohen përceptimet e laborantëve në lidhje me gabimet laboratorike dhe sigurinë e pacientit duke u bazuar në faktorë individual, social, faktorët lidhur me aktivitetin, me burimet, edukimin e trajnimin dhe raportimin e gabimeve.

*Metodologjia:* Në këtë hulumtim është përdorur metoda kuantitative e realizuar nga pyetësi i përgaditur nga komiteti SEQC (Marína, 2012). Të anketuarit ishin të gjithë laborantë mjekësore, prej tyre 51 femra dhe 21 meshkuj të moshës 18-64 vjeç, ku 50% (36 në total) prej tyre kanë qenë me shkollë të mesme, 33.3% (24 në total) me studime bazike dhe 16.7% (11 në total) me studime master. Të dhënat janë vlerësuar me shkallën e likertit dhe janë analizuar me paketën statistikore SPSS.

*Rezultatet:* Nga analizimi i të dhënave rezultojmë që: faktorët pajisjet dhe burimet mund të jenë indikatorë negativ në sigurinë e pacientit, ku sipas raportimit të laborantëve këta faktorë kishin nivel të ulët kënaqshmërie. Është shprehur një dallim signifikant në mes institucionit dhe faktorit pajisje dhe burime, ku vlera e  $p=.018$ . Sa i përket institucioneve QKUK kishte nivelin më të ultë kënaqshmërie, ndërsa laboratorët private më të lartin. Tek laboratorët, laboratorit hematologjik kishte nivelin më të ultë kënaqshmërie, ndërsa më të lartin laboratorit mikrobiologjik. Sa i përket raportimit të gabimeve klinike, është shprehur një përqindje prej 2.8% që nuk i raportojnë gabimet që ndodhin në laboratorin e tyre.

*Rekomandimet:* Kurrikula arsimore duhet t'i adresojë kompetencat e nevojshme për të përmirësuar sigurinë e pacientit. Rekomandohet që të hartohet një rutinë e cila përdor masa të vlefshme në monitorimin e laboratorit dhe të vlerësohen rezultatet e nxjerrura me qëllim që të arrihet një sistem i qëndrueshëm në minimizimin e gabimeve klinike.

*Fjalët kyçe:* Siguria e pacientit, gabimet klinike, faktorët ndikues